

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit G. L., nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson N. K., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Hekurudha e Kosovës “INFRAKOS” sh.a me seli në Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson e autorizuar K. Th., ... pranë të paditurës, për shkak të kontestit të punës, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.725/2014 datë 7.2.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.5.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.725/2014 datë 7.2.2019.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.725/2014 datë 7.2.2019, është aprovuar ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Pejë – Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.22/2011 i datës 11.11.2013, ashtu që është refuzuar si e pa bazuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit G. L., nga ..., tani me vendbanim në ..., me të cilin ka kërkuar që të anulohet akt-shkresa e të paditurës nr..., datë ..., Hekurudhat e UNMIK-ut, “TRAINKOS”, SH.A., me seli në Fushë Kosovë, paraardhësi juridik i Hekurudhave të Kosovës, SH.A. Sheshi i Lirisë pa numër, për përfundimin e kontratës së punësimit të paditësit, si e kundërligjshme, dhe të detyrohet e paditura “TRAINKOS” sh.a në Fushë Kosovë/Hekurudhat e Kosovës sh.a me seli në Fushë Kosovës, Sheshi i Lirisë, pa numër që paditësit t’ia pranojë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës sipas Kontratës së Punës nr..., datë ..., me shtrirje për periudhën karakteristike të specifikuar në intervalin kohor të caktuar prej 1.9.2003 e gjerë kur kishte për të skaduar Kontrata e Punës 31.8.2006 dhe atë në emër të pagave të pa paguara për kohen sa ka qen i larguar nga puna, duke i paguar paditësit: për vitin 2004, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetorë nga 325,00 €

për muaj, e që bëjnë në shumën me lartësi prej 975,00 €, për vitin 2005 për 12 (dymbëdhjetë) muaj të vitit nga 325.00 €, për muaj e që bëjnë në shumën e lartësisë prej 3900,00 € dhe për vitin 2006 për muajin: janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik dhe gusht, për çdo muaj nga 325,00 €, e që bëjnë shumën e lartësisë prej 2600,00 €, të gjitha këto me kamat ligjore prej 3,5% nga dita e arritjes për pagesë të secilës pagë e deri me pagimin definitiv, përfshirë edhe obligimin e të paditurës për pranimin e shpenzimeve për para procedurë e rishqyrtim sipas lëndës në shenjen e regjistrimit C.nr.367/04 me lartësi 550,00 €, si dhe shpenzimet e krijuara në riprocedurë, në lartësi prej 575,00 €, e që gjithsej bëjnë shumën e lartësisë prej 1406,04 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, deri në pagesën definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes nga neni 214 par.1 pika (a),(b),(c) të LPK-ës dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet ashtu që të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizion duke kundërshtuar pretendimet e revizionit, ndërsa ka propozuar që revizioni i paditësit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me kontratën nr. ..., datë ..., paditësi tek e paditura ka themeluar marrëdhënien e punës për kohë të caktuar nga data 1.9.2003 e deri më 31.8.2006, i sistemuar në vendin e punës shef i shërbimit të sigurimit. Me njoftimin nr. ..., datë 30.6.2004, e paditura paditësit ia ndërprente marrëdhënien e punës, për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27). Paditësi nuk ka shfrytëzuar të drejtën e tij për ta kundërshtuar pran të paditurës njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa gjykatës i është drejtuar me padi më datë 3.8.2004.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë duke aplikuar dispozitat ligjore nga neni 2.4 neni 12.2 pikat (a), (b), (c), (d) dhe (e) të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, dhe neni 1, neni 2 lidhur me nenin 3 shkronja (a), (b), (e), (f), dhe

nenit 6.2 të Ligjit mbi Diskriminimin, ka vlerësuar se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke konstatuar se paditësi nuk ka dëshmuar me prova relevante se është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme dhe diskriminuese dhe ka arsyetuar faktin se e paditura në mënyrë të drejt e ka zbatuar nenin 12 par. 2 pika (f) të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, e cila për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale të ndërmarrjes ka bërë reduktimin e 200 punëtorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar, nuk gjeti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, mbi bazën faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar. Kjo ngase, gjykata e shkallës së dytë me të drejt ka konstatuar se paditësi nuk ka dëshmuar me prova relevante se është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme dhe diskriminuese, por i njëjti është larguar nga puna sipas reduktimit të numrit të punëtorëve për shkak të ndryshimeve ekonomike, strukturale dhe teknologjike, ashtu siç e parashih dispozita e nenit 12 par. 2 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, të cilën dispozitë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar edhe e paditura me rastin e shpërndarjes së marrëdhënies së punës paditësit, e cila ka bërë reduktimin e 200 punëtorëve, në mesin e të cilëve është edhe paditësi.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv ngase menjëherë pas luftës së vitit 1999 me Hekurudhat e Kosovës ka menaxhuar UNMIK-u, i cili fakt është vërtetuar nga provat në shkresat e lëndës dhe vet kontrata e punësimit të paditësit e cila është e lidhur me Hekurudhat e UNMIK -ut. Nga data 27.8.2002, Hekurudha është regjistruar si N.P.SH. Hekurudhat e UNMIK-ut, ndërsa nga data 23.12.2005 është bërë bartja e administrimit

dhe menaxhimit të hekurudhave nga UNMIK-u në Hekurudhat e Kosovës dhe më datë 23.8.2011 inkorporohet si infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS Sh.A.

Duke u nisur nga këto që u thanë më lartë, mund të përfundohet se në këtë çështje juridike palë e paditur nuk mund të jenë Hekurudhat e Kosovës, kurse as Hekurudhat e UNMIK-ut, për shkak të statusit, privilegjeve dhe imunitetit të paraparë me nenin 3.1. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 datë 18 gusht 2000 sipas të cilës dispozitë juridike, UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij, janë të lira nga çfarëdo procesi gjyqësor.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e paditësit të cekur në revizion se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vërtetuar gjendje faktike tjetër nga gjykata e shkallës së parë dhe në këtë mënyrë nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar, por një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar, sepse dispozita e nenit 201 par. 1 pika (d) e LPK –ës përcakton se gjykata e shkallës së dytë mund ta ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë kur konstaton se gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë është konstatuar drejt, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar.

Pretendimin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme kur ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kjo Gjykatë e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme e të bazuara në ligj kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimet e paditësit të cekura në revizion se e paditura ka për obligim që me rastin e largimit të punësuarit nga puna për secilin rast individualisht, dhe për paditësin, të dëshmojë efektshmerinë në punë, shkathhtësitë profesionale, përvojën e punës, moshën dhe kriteret tjera sociale, por të njëjtat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilën në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK –ës , revizioni nuk mund të paraqitet.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.137/2019 datë 23.5.2019

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku